



REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dërrëzuar Punijues/Profdata Received/Delivered	07-04-2021	1	viti god year
Organ /Njësia Org /Unit	Nr Prot Pr Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKAMSHOK	1648/2021		113



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Anr. 120/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin e ankesave nga: Eshref Shabani, kryetare, Arben Mehmeti dhe, Malsore Gashi-Bajraktari anëtarë, me Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A. Nr. 120/2021, të datës 04.03.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi rruga „ Dëshmoret e Kombit”, pa numër nga Komuna e Vushtrrisë, kundër organit të punësimit Akademia e Kosovës për Siguri Publike, në çështjen juridike “ kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1, nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.3 dhe 1.4 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 07.04.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET pjesërisht si e bazuar** ankesa A.nr.120/2021 e datës 04.03.2021, e parashtruar nga ankuesi .
- II. **DETYROHET** Drejtori i Përgjithshëm i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike, dhe Mbikëqyrësi i Drejtpërdrejtë i ankuesit, që të ndër marr veprimet e duhura të përcaktuara me legjislacionin në fuqi, që ta përfshijë në trajnime, të Organizuar nga Instituti i Kosovës për Administratën Publike.
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi më datë 04.03.2021, me numër protokoll 972/2021, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për mos përfshirjen në trajnimin e organizuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike, për trajnimin e mbajtur me datë 08 dhe 09, të muajit shkurt të vitit 2021, për Procedurën Administrative.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 08.03.2021, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë të Akademia e Kosovës për Siguri Publike, ndërsa Akademia e Kosovës për Siguri Publike, më datë 17.03.2021 ka përcjell gjithë dokumentacionin lidhur me këtë lëndë.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A Nr 120/2021, e datës 04.03.2021, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Regjistrimi për pjesëmarrjen në trajnim; e- maili i datës 02.04.2021, i Planit Kalendarik i Trajnimeve nga Instituti i Kosovës për administratë Publike; e- maili i datës 19.01.2021, i Menaxherit të Personelit; e- maili i datës 13.01.2021, i Menaxherit të Personelit; e- maili i datës 04.02.2021, i Menaxherit të Personelit; e- maili i datës 24.02.2021, i Menaxherit të Personelit; Plani i Trajnimeve për vitin 2021; e- maili i datës 11.03.2021, i Menaxherit të Personelit; e- maili i datës 01.03.2021, i e- maili i datës 04.02.2021; Plani i Trajnimeve i Nëpunësit Civil për periudhën janar 2021 dhjetor 2021; e- maili i datës 15.03.2021; Përgjigje në ankesë e datës 17.03.2021, me numër protokollit 1206/2021, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e parashtruar nga ankuesi është **pjesërisht e bazuar, sepse:**

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit Agron Avdiu, i cili pretendon se nuk është njoftuar nga Udhëheqësi i Drejtpërdrejtë dhe Menaxheri i Personelit, për trajnimin e Organizuar nga Instituti i Kosovës për Administratën Publike, për datën 08, dhe 09, të muajit Shkurt, të vitit 2021, për Procedurën Administrative. Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se pretendimet ankimore të ankuesit janë në pajtim me dispozitat ligjor në fuqi.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Plani i Trajnimeve për vitin 2021, me datën 13.02.2021, është nënshkruar nga Udhëheqësi i Divizionit të Trajnimeve, si mbikëqyrës i drejtpërdrejtë dhe ankuesi, ku në planin e trajnimeve është përfshirë nevoja nga ankuesi për të vijuar trajnimin për Procedurën Administrative, ndërsa nga shkresat e lëndës në e- maili e datës 04.02.2021, të dërguar nga del se ankuesin e ka njoftuar se e keni ndjekur trajnimin dhe se nuk keni nevojë me ndjek trajnimin për procedurën Administrative, me arsyetimin se ankuesi e ka mbajtur trajnimin për procedurën Administrative, me datë 05-06, të vitit 2014.

Ndërlidhur me pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon se i është mohuar pjesëmarrja në trajnimin nga Mbikëqyrësi i Drejtpërdrejtë, i cili ka konstatuar se trajnimin për procedurën Administrative, ankuesi e ka mbajtur me datën 05-06, të vitit 2014, ndërsa nuk ka nevojë për këtë trajnim, të organizuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike, për procedurën Administrative, Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se pretendimet ankimore të ankuesit janë në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, sepse kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ka hyre në fuqi me datë 21.06.2016, ndërsa trajnimin të cilin ankuesi e ka realizuar me datën 05-06, të vitit 2014, ka qene në fuqi Ligjit Nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative, i cili ligji është shfuqizuar sipas Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, duke analizuar legjisllacionin në fuqi, ka konstatuar se pretendimet ankimore të ankuesit janë në pajtim me dispozitat e nenit 23, të Ligjit Nr. 06/L – 114 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se; ***Nëpunësit civilë kanë të drejtën të përmirësojnë aftësitë profesionale për vendin e punës nëpërmjet formimit profesional dhe trajnimeve të vazhdueshme të financuara nga fondet publike, nga***



donatorë të huaj apo nga të ardhurat vetanake”, prandaj Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se trajnimet për nëpunësit civil janë të përcaktuar me dispozitat ligjore në fuqi dhe se institucionet duhet ti përfshijnë nëpunësit civil në trajnime dhe të veprojnë në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se organi i punësimit Akademia e Kosovës për Siguri Publike, pas pranimit të vendimit të Këshillit, Mbikëqyrësi i Drejtpërdrejtë i ankuesit është i obliguar që në rastin e organizimit të trajnimeve nga organi kompetent Instituti i Kosovës për Administratë Publike, të përfshijë ankuesi në trajnime, në bazë të kërkesa të parashtruar nga vet ankuesi, dhe të shërbejë për aftësisë profesionale të tij dhe për nevoja e punës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, bazuar në këto rrethana, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmarr të gjitha veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligji Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.*

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda Nr. A. Nr. 120/2021**

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet:

Ankuesit;

Drejtorit të Përgjithshëm në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike;

Udhëheqësit të Personelit në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike;

Arkivit të KPMSHCK-së

